



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 25478 Prot

Shkodër, më 12.12.2025

**DËRGIM PROJEKT-VENDIM DHE RELACION  
KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**

**Të nderuar këshilltar !**

Bashkangjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shpjegues “**Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri**”

► Ky projekt-vendim dhe relacion përmban këtë dokumentacion:

- Shkresë përcjellëse – 1 (një) fletë
- Projektvendim – 3 (tre) fletë
- Relacion – 3 (tre) fletë
- Vlerësimi i orendive, mobiljeve dhe pajisjeve elektroshtepiake – 5 (pesë) fletë
- Preventivi i punimeve ndërtimore – 8 (tetë) fletë
- Proçesverbal konstatimi – 4 (katër) fletë
- Planimetri – 4 (katër) fletë
- Urdhër pune – 2 (dy) fletë
- Kërkesë për ndihmë financiare në rast djegie banese – 4 (katër) fletë
- Saktësim adrese – 7 (shtatë) fletë
- Vërtetim për rënie zjarri – 4 (katër) fletë
- Çertifikatë familjare – 4 (katër) fletë
- Kartë ID – 4 (katër) fletë

Nr.kopje 4(katër)

**KRYETAR**  
**Benet BECI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2025

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2025

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME  
DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS  
FINANCIARE PËR FAMILJEN E NDUE RRETHAJ, LULZIM SELJA, MEJREME  
SAMINI, ZAMIR SYLIA, BANESA E TË CILEVE ËSHTË DËMTUAR NGA  
ZJARRI”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_ 2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar; Ligjin nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”; Ligjin nr.68/2017 ‘Për financat vendore’ i ndryshuar; VKM nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“; VKM nr. 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar; VKB Nr 76 datë 19.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës” i ndryshuar, VKB Nr 33 datë 29.05.2025 Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar me VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar, si dhe në Relacionin nr \_\_\_\_\_ prot, datë \_\_\_\_\_ e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

**VENDOSI :**

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së **Ndue Rrethaj** (4 anëtarë familje), në vlerën prej 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë (sipas certifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **Ndue Rrethaj** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 921 927 (nëntëqind e njëzet e një mijë e nëntëqind e njëzet e shtatë) lekë dhe për dëmet në orendi prej 467 052 (katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e dy) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **Ndue Rrethaj**.

3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së **Lulzim Selja** (5 anëtarë familje), në vlerën prej 100 000 (njëqind mijë) lekë (sipas çertifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri .
4. Për familjen e **Lulzim Selja** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 364 322 (treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e njëzet e dy) lekë dhe për dëmet në orendi prej 421 040 (katërqind e njëzet e një mijë e dyzet)lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **Lulzim Selja**.
5. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së **Mejreme Samini** (5 anëtarë familje), në vlerën prej 100 000 (njëqind mijë) lekë (sipas çertifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri.
6. Për familjen e **Mejreme Samini** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 332 351 (treqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e pesëdhjetë e një) lekë dhe për dëmet në orendi prej 208 156 (dyqind e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **Mejreme Samini**.
7. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së **Zamir Sylia** (5 anëtarë familje), në vlerën prej 100 000 (njëqind mijë) lekë (sipas çertifikatës familjare të paraqitur), për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri.
8. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e **Zamir Sylia** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 1 725 262 (një milion e shtatëqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë dhe për dëmet në orendi prej 284 656 (dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e **Zamir Sylia**.
9. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile parashikuar në programin **AB141** “ Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile” në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2025 të miratuar me VKB Nr 76 datë 19.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës”, i ndryshuar, në programin **AB141, Q2 O1 A4** “ Përbalimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 380 000 (treqind e tetëdhjetë mijë) lekë. Ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër për likuidimin e ndihmës së menjëhershme.
10. Për familjen e **Ndue Rrethaj, Lulzim Selja, Mejreme Samini, Zamir Sylia** kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore dhe në orendi e pajisje do të bëhet sipas preventivave të vlerësimit hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të Ligjit 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile “ neni 41 , të VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 pika 3 dhe të VKM-së Nr. 414 datë 08.07.2021 pika 3.1/a “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile, “VKB Nr 33 datë 29.05.2025 Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar me VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar ,sipas Relacionit bashkëngjitur, në masen 50 % të vlerës ndërtimore në shumën **1 671 932** (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e

tridhjetë e dy) lekë dhe në masen 50% të vlerës së orendive në shumën **690 452** (gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e katëqind e pesëdhjetë e dy) lekë.

**11.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**  
**Benet BECI**

- **ZV.KRYETAR**

Alban Bekri

- **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MENAXHIMIT FINANCIAR**

Elvin DRAHIMI

- **DREJTORIA E ANALIZËS DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR**

Arta Hoxha

- **DREJTORIA E FINANCËS**

Blerta Hoxha

- **DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE , BURIMEVE NJEREZORE DHE SHERBIMEVE MBESHTETËSE**

Artur

- **DREJTORIA JURIDIKE**

B. Lufino

- **DREJTORIA EMERGJENCAVE CIVILE**

Xhelmet Dini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA EMERGJENCIVE CIVILE**

Nr. 25478/ Prot

Shkodër, më 12.11.2025

**RELACION**  
**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**

**Të nderuar këshilltarë!**

Në vijim të procedurave për shkak të rënies së zjarrit në banesën e shtetasve: **Ndue Rrethaj**, banor në Rrugën “Mahalle”, fshati Plan, Nj/A. Pult dëmtuar nga zjarri i rënë më datë 06.11.2025, **Lulzim Selja**, banor në Rrugën “Pazarit”, Lagjia nr. 4, dëmtuar nga zjarri i rënë më datë 11.11.2025, **Mejreme Samini**, banor në Rrugën “Pazarit”, Lagjia nr. 4, dëmtuar nga zjarri i rënë më datë 11.11.2025, **Zamir Sylia**, banor në Rrugën “Tahir Dizdari”, Lagjia Nr.1, dëmtuar nga zjarri i rënë më datë 07.11.2025, bazuar në Ligjin nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, V.K.M. nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.”,

I. Ju paraqesim këtë propozim për dhënie të ndihmës së menjëhershme financiare si më poshtë: Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile parashikuar në programin AB141 “Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile” në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2025 të miratuar me VKB Nr 76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës” i ndryshuar, në programin AB141, Q2 O1 A4 “Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 380 000 (treqind e tetëdhjetë mijë ) lekë. Ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër për likuidimin e ndihmës së menjëhershme.

| Nr | Emri i kryefamiljarit | Numri i personave sipas çertifikatës familjare | Koha kur është djegur ose dëmtuar banesa | Data e paraqitjes së kërkesës | Ndihma financiare e propozuar |
|----|-----------------------|------------------------------------------------|------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
|    |                       |                                                |                                          |                               |                               |

|   |                     |   |            |            |                |
|---|---------------------|---|------------|------------|----------------|
| 1 | Ndue Rrethaj        | 4 | 06.11.2025 | 07.11.2025 | 80 000         |
| 2 | Lulzim Selja        | 5 | 11.11.2025 | 13.11.2025 | 100 000        |
| 3 | Mejreme Samini      | 5 | 11.11.2025 | 14.11.2025 | 100 000        |
| 4 | Zamir Sylia         | 5 | 07.11.2025 | 13.11.2025 | 100 000        |
|   | <b>Shuma Totale</b> |   |            |            | <b>380 000</b> |

## II. Për familjen e **Ndue Rrethaj, Lulzim Selja, Mejreme Samini dhe Zamir Sylia**

kompensimi i dëmëve materiale ndërtimore dhe në orendi e pajisje do të bëhet sipas preventivave të vlerësimit, hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të Ligjit 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile “ neni 41 , të VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 pika 3 dhe të VKM-së Nr. 414 datë 08.07.2021 pika 3.1/a “ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile ,“VKB Nr 33 datë 29.05.2025 Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar me VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar sipas Relacionit bashkëngjitur, në masen 50 % të vlerës ndërtimore në shumën 460 964(katërqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë dhe në masen 50% të vlerës së orendive në shumën 233 526 (dyqind e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e gjashtë) lekë për familjen e **Ndue Rrethaj**, sipas Relacionit bashkëngjitur, në masen 50 % të vlerës ndërtimore në shumën 182 161 (njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë dhe në masen 50% të vlerës së orendive në shumën 210 520 (dyqind e dhjetë mijë e pesëqind e njëzet) lekë për familjen e **Lulzim Selja**, sipas Relacionit bashkëngjitur, në masen 50 % të vlerës ndërtimore në shumën 166 176 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë dhe në masen 50% të vlerës së orendive në shumën 104 078 (njëqind e katër mijë e shtatëdhjetë e tetë) lekë për familjen e **Mejreme Samini**, sipas Relacionit bashkëngjitur, në masen 50 % të vlerës ndërtimore në shumën 862 631 (tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e një) lekë dhe në masen 50% të vlerës së orendive në shumën 142 328 (njëqind e dyzet e dy mijë e treqind e njëzet e tetë) lekë për familjen e **Zamir Sylia**.

► Tabela e përfitimit sipas dëmeve ndërtimore dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake është:

| Nr | Emri familjes | Vlera ndërtimore | Vlera e orendive | Vlera ndërtimore dhe e orendive | 50 % Vlera ndërtimore | 50 % Vlera e orendive | 50 % Vlera ndërtimore dhe e orendive | Humbja e jetës | Dëmshpërblim për humbje jete |
|----|---------------|------------------|------------------|---------------------------------|-----------------------|-----------------------|--------------------------------------|----------------|------------------------------|
|    |               | 1                | 2                | 1 + 2                           | 4                     | 5                     | 4 + 5                                | 6              | 7                            |

|   |                                |                  |                  |                  |                  |                |                  |   |   |
|---|--------------------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|----------------|------------------|---|---|
| 1 | Ndue Rrethaj                   | 921 927          | 467 052          | 1 388 979        | 460 964          | 233 526        | 694 490          | - | - |
| 2 | Lulzim Selja                   | 364 322          | 421 040          | 785 362          | 182 161          | 210 520        | 392 681          | - | - |
| 3 | Mejreme Samini                 | 332 351          | 208 156          | 540 507          | 166 176          | 104 078        | 270 254          | - | - |
| 4 | Zamir Sylia                    | 1 725 262        | 284 656          | 2 009 918        | 862 631          | 142 328        | 1 004 959        | - | - |
|   | <b>Shuma<br/>përfundimtare</b> | <b>3 343 862</b> | <b>1 380 904</b> | <b>4 724 766</b> | <b>1 671 932</b> | <b>690 452</b> | <b>2 362 384</b> | - | - |

**KRYETAR**  
**Benet BECI**

**DREJTORI**  
**Xhehnet DANI**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al) Tel: +35522400150

Numri i praktikës: 8609

Datë: 07/11/2025

**KËRKESË**

Unë i/e nëshkruari/a Ndue Rrethaj me numër personal 0682266022 , banues në Pult , .

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9355 datë 10-03-2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" të ndryshuar ,Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 329 datë 16-05-2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" ;

**KËRKOJ**

Trajtimin me "Ndihmë financiare në rast djegie banese".

**Aplikanti**

Ndue Rrethaj

**Specialisti i zyrës me një ndalesë**

Dajana Cico



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA ESHËRBIMIT TE MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT**

Nr 577/1 Prot

Shkodër, me 07.11.2025

**VËRTETIM**

**Për rënie zjarri**

Vërtetohet se me datë 06.11.2025 Ora 10.29 është djegur një banesë në katin e parë.  
Në adresë: Fshati, Grud e Re. Njesia Adm Rrethina. Shkodër.  
Pronë e shtetasit Ndue Rrethaj,  
Kjo banesë përbehet nga një kuzhinë, dhomë gjumi koridor dhe banjo. Si pasojë e zjarrit të rënë është djegur aneksi me orëndi si banak kundërbanak pothuajse komplet si dhe një pjesë e kuzhines, është dëmtuar nga tymi dhe bloza. Gjithashtu edhe pjesa tjetër e banesës si dhoma, dhe koridori janë dëmtuar nga tymi dhe bloza.  
Në këtë zjarr ka marrë pjesë personeli i MZSH-së i stacionit të Shkodrës i turnit të 1(parë) me komandant turni Sokol Murati me automjetin zjarrfikës Benz me targë AB114PP me datë 06.11.2025 në orën 10:29 Nga ndërhyrja e jonë u bë e mundur mos perhapja e zjarrit në banesat përreth.  
Stacioni i MZSH-së disponon dokumentacionin përkatës që vërteton rënien e këtij zjarri.  
Ky vërtetim mbahet në tre kopje dhe përpilohet me kërkesën e të interesuarve për ta përdorur sipas nevojës.

**DREJTORI i MZSH-së**

(Komanduar)

Agim PONARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Bashkia Shkodër  
Njësia administrative Pult  
Zyra e Gjendjes Civile 345

CERTIFIKATË FAMILJARE

Data: 07.11.2025

Në bazë të Regjistri Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

| Nr. | Emri e Mbiemri   | Emri i Babait | Emri i Nënës | Gjinia | Lidhja me K. Familjarin | Data lindja | Gjendja Civile | Vendlindja    | Shtetësia | Numri Personal |
|-----|------------------|---------------|--------------|--------|-------------------------|-------------|----------------|---------------|-----------|----------------|
| 1.  | Ndue RRETHAJ     | Kolë          | File         | M      | Kryefamiljar            | 11-03-1983  | I/e martuar    | Plan, Shkodër | Shqiptare | I30311042E     |
| 2.  | Gjyste RRETHAJ   | Dedë          | Dilë         | F      | bashkeshortë            | 13-04-1982  | I/e martuar    | Pog, Shkodër  | Shqiptare | I25413049N     |
| 3.  | Florian RRETHAJ  | Ndue          | Gjyste       | M      | I Biri                  | 28-12-2006  | Begar/e        | Shkodër       | Shqiptare | K61228031J     |
| 4.  | Riginald RRETHAJ | Ndue          | Gjyste       | M      | I Bin                   | 28-09-2012  | Begar/e        | Shkodër       | Shqiptare | L20928026M     |
| 5.  | -----            | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----         | -----     | -----          |
| 6.  | -----            | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----         | -----     | -----          |
| 7.  | -----            | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----         | -----     | -----          |
| 8.  | -----            | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----         | -----     | -----          |
| 9.  | -----            | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----         | -----     | -----          |
| 10. | -----            | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----         | -----     | -----          |

Kjo certifikatë lëshohet për  
Përbeja familjare, datë 06.11.2025



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e  
Regjistrimit të Gjendjes Civile  
Data: 20251107 10:46:43 +0200  
3a6e6d7eb0da465da3a17be5ba22

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Regjistrimit të Gjendjes Civile)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË**  
**TERRITORIT**  
**SISTEMI ADRESAVE**  
**Njesia Administrative Pult**

Nr 148 Prot

Numri i praktikës: 8601  
Shkodër, më: 07-11-2025

**Lënda:** Saktësim adrese

Në përgjigje të kërkesës me numër praktike 8601 , datë 07/11/2025 , bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, dhe në ligjin nr.9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” të ndryshuar, vërtetojmë se Z. Ndue Kolë Rrethaj, me ID 130311042E , është banues në:

Rruga. Mahalle, N. 12, H. 1 ,

Fshati Plan, Njesia Administrative Pult, 4010 , Shkodër.

Ky vërtetim lëshohet për plotesim dokumentacioni.

**ADMINISTRATORI**

  
**Aleksander RROKU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË**  
**TERRITORIT**  
**SISTEMI ADRESAVE**  
**Njesia Administrative Pult**

Nr 147 Prot

Numri i praktikës: 8602  
Shkodër, më: 07-11-2025

**Lënda: Saktësim adrese**

Në përgjigje të kërkesës me numër praktike 8602 , datë 07/11/2025 , bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, dhe në ligjin nr.9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” të ndryshuar, vërtetojmë se Znj. Gjyste Dedë Rrethaj, me ID 125413049N , është banues në:

Rruga, Mahalle, N. 12, H. 1 ,

Fshati Plan, Njesia Administrative Pult, 4010 , Shkodër.

Ky vërtetim lëshohet për plotësim dokumentacioni.

ADMINISTRATORI

  
Aleksander RROKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË**  
**TERRITORIT**  
**SISTEMI ADRESAVE**  
**Njesia Administrative Pult**

Nr 146 Prot

Numri i praktikës: 8603  
Shkodër, më: 07-11-2025

**Lënda:** Saktësim adrese

Në përgjigje të kërkesës me numër praktike 8603 , datë 07/11/2025 , bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, dhe në ligjin nr.9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” të ndryshuar, vërtetojmë se Z. Florjan Ndue Rrethaj, me ID K61228031J , është banues në:

Rruga, Mahalle, N. 12, H. 1 ,

Fshati Plan, Njesia Administrative Pult, 4010 , Shkodër.

Ky vërtetim lëshohet për plotësim dokumentacioni.

ADMINISTRATORI

  
Aleksander RROKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË**  
**TERRITORIT**  
**SISTEMI ADRESAVE**  
**Njesia Administrative Pult**

Nr 145 Prot

Numri i praktikës: 8604  
Shkodër, më: 07-11-2025

**Lënda: Saktësim adrese**


Në përgjigje të kërkesës me numër praktike 8604 , datë 07/11/2025 , bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, dhe në ligjin nr.9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” të ndryshuar, vërtetojmë se Riginald Ndue Rrethaj, me ID L20928026M , është banues në:

Rruga, Mahalle, N. 12, H. 1 ,

Fshati Plan, Njesia Administrative Pult, 4010 , Shkodër.

Ky vërtetim lëshohet për plotësim dokumentacioni.

**ADMINISTRATORI**

  
**Aleksander RROKU**







**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al) e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al) Tel: +35522400150

Numri i praktikës: 8788

Datë: 14/11/2025

## KËRKESË

Unë i/e nëshkruari/a Lulzim Maliq Selja me numër personal 0698559643 , banues në Pazar i vjeter ,Shkoder , .

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9355datë 10-03-2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" të ndryshuar ,Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 329 datë 16-05-2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" ;

### KËRKOJ

Trajtimin me "Ndihmë financiare në rast djegie banese".

Në rast të miratimit të ndihmës financiare, do të kërkoja që pagesa të bëhej në llogarinë time bankare në në llogarinë bankare:

Emri i llogarisë:

Numër ,

IBAN

Bashkëlidhur kam dorëzuar dokumentat e nevojshme.


**Aplikanti**

Lulzim Selja

**Specialisti i zyrës me një ndalesë**

Eva Paloka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Shkodër

Njësia administrative Shkodër

Zyra e Gjendjes Civile 332



Date: 14.11.2025

## CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

| Nr. | Emri e Mbiemri | Emri i Babait | Emri i Nënës | Gjinia | Lidhja me K. Familjarin | Data lindja | Gjendja Civile | Vendlindja | Shtetësia | Numri Personal |
|-----|----------------|---------------|--------------|--------|-------------------------|-------------|----------------|------------|-----------|----------------|
| 1.  | Lulzim SELJA   | Maliq         | Zyli         | M      | Kryefamiljar            | 22-12-1986  | I/e martuar    | Shkodër    | Shqiptare | 161222074G     |
| 2.  | Dorina SELJA   | Zemeri        | Rudina       | F      | Bashkëshorte            | 23-06-1992  | I/e martuar    | Shkodër    | Shqiptare | J25623079W     |
| 3.  | Adela SMETI    | Agim          | Dorina       | F      | Vajza E Gruas           | 17-11-2011  | Begar/e        | Shkodër    | Shqiptare | L16117080H     |
| 4.  | Mimoza SELJA   | Lulzim        | Dorina       | F      | E Bija                  | 05-06-2016  | Begar/e        | Shkodër    | Shqiptare | L65605045A     |
| 5.  | Armin SELJA    | Lulzim        | Dorina       | M      | I Biri                  | 31-08-2017  | Begar/e        | Shkodër    | Shqiptare | L70831038G     |
| 6.  | Arruna SELJA   | Lulzim        | Dorina       | F      | E Bija                  | 12-05-2019  | Begar/e        | Shkodër    | Shqiptare | L95512005H     |
| 7.  | Alitana SELJA  | Lulzim        | Dorina       | F      | E Bija                  | 15-05-2021  | Begar/e        | Shkodër    | Shqiptare | M15515002C     |
| 8.  | Muhamet SELJA  | Lulzim        | Dorina       | M      | I Biri                  | 01-09-2023  | Begar/e        | Shkodër    | Shqiptare | M30901007L     |
| 9.  | Matia SELJA    | Lulzim        | Dorina       | M      | I Biri                  | 20-11-2024  | Begar/e        | Shkodër    | Shqiptare | M41120001C     |
| 10. |                |               |              |        |                         |             |                |            |           |                |

Kjo certifikatë lëshohet për \_\_\_\_\_

Përfaqësim familjar, datë 14.11.2025



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e  
Përgjithshme e Gjendjes Civile  
Datë 2025/11/14 09:16:59 +0200  
565e04db9a4e46233c04a0d7a8202

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtorate e Përgjithshme e Gjendjes Civile)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA ESHËRBIMIT TE MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT**

Nr 583/ Prot

Shkodër, me 12.11.2025

**VËRTETIM**

**Për rënie zjarri**

Vërtetohet se me datë 11.11.2025 Ora 10.43 është djegur një banesë ne katin e parë.

Në adresë: Lagje Iliria. Pazarë. Shkodër.

Pronë e shtetasit Lulzim Selja.

Kjo banesë përbehej nga një kuzhinë dhe aneks ,dhomë gjumi koridor dhe banjo.

Si pasojë e zjarrit të rënë është djegur komplet banesa me të gjitha orënditë e ndodhura ne te.

Në këtë zjarr ka marrë pjesë personeli i MZSH-së i stacionit të Shkodrës i turnit të 1(parë) me komandant turni Edison Suma me 3 automjete zjarrfikës Benz me targë AB114PP Iveko 4 tomshe dhe 8 tonshe se me datë 11.11.2025 në orën 10:<sup>43</sup> Nga ndërhyrja e jonë u bë e mundur mos perhapja e zjarrit në banesat përreth.

Stacioni i MZSH-së disponon dokumentacionin përkatës që vërteton rënien e këtij zjarri.

Ky vërtetim mbahet në tre kopje dhe përpilohet me kërkesën e të interesuarve për ta përdorur sipas nevojës.

**DREJTORI i MZSH-së**

(Komanduar)

Agim PONARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**  
**SISTEMI ADRESAVE**

Nr 8759/1 Prot

Numri i praktikës: 8759  
Shkodër 14.11.2025

**Lënda: Saktësim adrese**

Në përgjigje të kërkesës me numër praktike 8761, datë 13/11/2025, bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", dhe në ligjin nr.9270, datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave" të ndryshuar, vërtetojmë se Lulzim Maliq Selja, me ID I61222074G, është banues në:

Rr. Pazarit

Shkodër Lagjja numer 4, 4001

Ky vërtetim lëshohet për dokumenta (shtëpi te djegura).

**KRYETAR**

**BENET BECI**

**Me vendim delegimi**

**ZV/KRYETAR**

**ALBAN PREKA**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al), Tel: +35522400150

Numri i praktikës: 8789

Datë: 14/11/2025

## KËRKESË

Unë i/e nëshkruari/a Mejreme Selim Samini me numër personal 0692803684 , banues në Pazar i vjeter ,Shkoder , .

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9355 datë 10-03-2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" të ndryshuar ,Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 329 datë 16-05-2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" ;

### KËRKOJ

Trajtimin me "Ndihmë financiare në rast djegie banese".

Në rast të miratimit të ndihmës financiare, do të kërkoja që pagesa të bëhej në llogarinë time bankare në në llogarinë bankare:

Emri i llogarisë:

Numër ,

IBAN

Bashkëlidhur kam dorëzuar dokumentat e nevojshme.

**Aplikanti**

Mejreme Samini

**Specialisti i zyrës me një ndalesë**

Eva Paloka

LETËRNJOFTIM ID REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA

matëri/surname  
**Samini**  
emri/given name  
**Mejreme**  
adresa/nationality  
**Shqiptare/Albanian**  
vendndje/place of birth  
**Shkodër, ALB**  
data lindje/date of birth  
**06-02-1969**  
data e tërëmit/date of issue  
**13-07-2020**  
autoriteti/issued/authority  
**MPB**

numëri i dokumentit no  
**036203568**  
gjinia/sex  
**F**  
data e skadimit/date of expiry  
**12-07-2030**  
nr personal/personal no  
**G95206071D**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Bashkia Shkodër  
Njësia administrative Shkodër  
Zyra e Gjendjes Civile 332

Datë: 12.11.2025

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

| Nr. | Emri e Mbiemri  | Emri i Babait | Emri i Nënës | Gjinia | Lidhja me K. Familjarin | Datëlindja | Gjendja Civile | Vendlindja | Shtetësia | Numri Personal |
|-----|-----------------|---------------|--------------|--------|-------------------------|------------|----------------|------------|-----------|----------------|
| 1.  | Mejreme SAMINI  | Selim         | Kymete       | F      | Kryefamiljar            | 06-02-1969 | I/e ve         | Shkodër    | Shqiptare | G95206071D     |
| 2.  | Ilvirjan SAMINI | Refik         | Mejreme      | M      | I Biri                  | 15-06-1986 | Beqar/e        | Shkodër    | Shqiptare | I60615116H     |
| 3.  | Irjon SAMINI    | Refik         | Mejreme      | M      | I Biri                  | 27-08-1988 | I/e martuar    | Shkodër    | Shqiptare | I80827081J     |
| 4.  | Erisa SAMINI    | Petrit        | Lirë         | F      | E Reja                  | 27-10-1996 | I/e martuar    | Lezhë      | Shqiptare | J66027065O     |
| 5.  | Ernita SAMINI   | Irjon         | Erisa        | F      | Mbesa                   | 21-08-2016 | Beqar/e        | Tiranë     | Shqiptare | L65821031B     |
| 6.  | Erjonid SAMINI  | Irjon         | Erisa        | M      | Nipi                    | 16-08-2018 | Beqar/e        | Tiranë     | Shqiptare | L80816046P     |
| 7.  | Ejisi SAMINI    | Irjon         | Erisa        | F      | Mbesa                   | 08-07-2020 | Beqar/e        | Tiranë     | Shqiptare | M05708032F     |
| 8.  | -----           |               |              |        |                         |            |                |            |           |                |
| 9.  | -----           |               |              |        |                         |            |                |            |           |                |
| 10. | -----           |               |              |        |                         |            |                |            |           |                |

Kjo certifikatë lëshohet për

Përbërja familjare, datë 11.11.2025



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e  
Përgjithshme e Gjendjes Civile  
Date: 2025/11/12 11:17:40 +0200  
1e92ea33a194031a3f1ac66220425f1



Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA ESHËRBIMIT TE MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT**

Nr 585 Prot  
11

Shkodër, me 12.11.2025

**VËRTETIM**

**Për rënie zjarri**

Vërtetohet se me datë 11.11.2025 Ora 10.43 është djegur një banesë ne katin e parë.  
Në adresë: Lagje Iliria. Pazarë. Shkodër.  
Pronë e shtetases Mejreme Samini  
Kjo banesë përbehej nga një kuzhinë dhe banjo.  
Si pasojë e zjarrit të rënë është djegur komplet banesa me të gjitha orënditë e ndodhura ne te.  
Në këtë zjarr ka marrë pjesë personeli i MZSH-së i stacionit të Shkodrës i turnit të 1(parë) me komandant turni Edison Suma me 3 automjete zjarrfikës Benz me targë AB114PP Iveko 4 tomshe dhe 8 tonshe se me datë 11.11.2025 në orën 10:<sup>43</sup> Nga ndërhyrja e jonë u bë e mundur mos perhapja e zjarrit në banesat përreth.  
Stacioni i MZSH-së disponon dokumentacionin përkatës që vërteton rënien e këtij zjarri.  
Ky vërtetim mbahet në tre kopje dhe përpilohet me kërkesën e të interesuarve për ta përdorur sipas nevojës.

**DREJTORI i MZSH-së**

(Komanduar)

Agim PONARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**  
**SISTEMI ADRESAVE**

Nr 8758/1 Prot

Numri i praktikës: 8758  
Shkodër 14.11.2025

**Lënda: Saktësim adrese**

Në përgjigje të kërkesës me numër praktike 8761, datë 13/11/2025, bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", dhe në ligjin nr.9270, datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave" të ndryshuar, vërtetojmë se Mejreme Selim Samini, me ID G95206071D, është banues në:

Rr. Pazarit

Shkodër Lagjja numer 4, 4001

Ky vërtetim lëshohet për dokumenta (shtëpi te djegura).

**KRYETAR**

**BENET BECI**

**Me vendim delegimi**

**ZV/KRYETAR**

**ALBAN PREKA**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al) e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al) Tel: +35522400150

Numri i praktikës: 8779

Datë: 13/11/2025

## KËRKESË

Unë i/e nëshkruari/a Zamir Zyhdi Sylia me numër personal 0696787077 , banues në Rruga: Tahir Dizdari , .

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9355 datë 10-03-2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" të ndryshuar ,Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 329 datë 16-05-2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" ;

### KËRKOJ

Trajtimin me "Ndihmë financiare në rast djegie banese".

**Aplikanti**

Zamir Sylia

**Specialisti i zyrës me një ndalesë**

  
Bep Capeli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**  
**SISTEMI ADRESAVE**

Nr. 8757/1 Prot

Numri i praktikës: 8757  
Shkodër 13.11.2025

**Lënda: Saktësim adrese**

Në përgjigje të kërkesës me numër praktike 8757 , datë 12/11/2025, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, dhe në ligjin nr.9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” të ndryshuar, vërtetojmë se Z. Zamir Zyhdi Sylia, me ID G90516106D, është banues në:

Rr. Tahir Dizdari

Shkodër Lagjja numer 1, 4001

Ky vërtetim lëshohet për dokumenta.

**KRYETAR**

**BENET BECI**

Me vendim delegimi  
ZV/KRYETAR  
RUDIN BEKA



LETTER/OF THE ID



REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA



mbiemri/surname

**Sylla**

emri i plotë name

**Zamir**

shprehja kombëtare nationality

**Shqiptare/Albanian**

vendndëshja/seat of birth

**Shkodër, ALB**

data e lindjes date of birth

**16-05-1969**

data e (ri)lindjes date of issue

**06-02-2023**

autoriteti i shprehjes authority

**MPB**

firmatimi signature

*Zamir Sylla*

nr. i identifikimit/card no

**038782016**

gjinia sex

**M**

data e validimit/date of expiry

**05-02-2033**

nr. personal/personal no.

**G90516106D**






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Shkodër

Njësia administrative Shkodër

Zyra e Gjendjes Civile 332



Data: 12.11.2025

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

| Nr. | Emri e Mbiemri  | Emri i Babait | Emri i Nënës | Gjinia | Lidhja me K. Familjarin | Data lindja | Gjendja Civile | Vendlindja | Shtetësia | Numri Personal |
|-----|-----------------|---------------|--------------|--------|-------------------------|-------------|----------------|------------|-----------|----------------|
| 1.  | Zamir SYLLIA    | Zyhd          | Reshadije    | M      | Kryefamiljar            | 16-05-1969  | I/e martuar    | Shkodër    | Shqiptare | G90516106D     |
| 2.  | Gentiana SYLLIA | Qerim         | Lumnije      | F      | Bashkëshorte            | 10-02-1974  | I/e martuar    | Shkodër    | Shqiptare | H45210131U     |
| 3.  | Sajmir SYLLIA   | Zamir         | Gentiana     | M      | I Biri                  | 24-09-1994  | I/e martuar    | Shkodër    | Shqiptare | J40924092J     |
| 4.  | Hamide SYLLIA   | Afrim         | Arta         | F      | E Reja                  | 20-01-1998  | I/e martuar    | Kavajë     | Shqiptare | J85120084L     |
| 5.  | Dars SYLLIA     | Sajmir        | Hamide       | M      | Nipi                    | 04-12-2024  | Begar/e        | Tiranë     | Shqiptare | M41204023N     |
| 6.  | -----           | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----      | -----     | -----          |
| 7.  | -----           | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----      | -----     | -----          |
| 8.  | -----           | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----      | -----     | -----          |
| 9.  | -----           | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----      | -----     | -----          |
| 10. | -----           | -----         | -----        | -----  | -----                   | -----       | -----          | -----      | -----     | -----          |

Kjo certifikatë lëshohet për

Përbëjia familjare, datë 07.11.2025



Vulosur elektronikisht nga Drejtorja e  
Përgjithshme e Gjendjes Civile  
Date: 2025/11/2 11:52:31 +0200  
c829412550434be6bc19ed8bb0ff1aac2

Shënim : Ky dokument është sjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA ESHËRBIMIT TE MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT**

Nr 584 Prot

Shkodër, me 12.11.2025

**VËRTETIM**

**Për rënie zjarri**

Vërtetohet se me datë 07.11.2025 Ora 19.20 është djegur një banesë

Në adresë: L. Bâhcja e Cakajve Rr. Tahir Dizdari .Shkodër.

Pronë e shtetasit Zamir Sylia,

Kjo banesë përbehej nga tre kate .Si pasojë e zjarrit të rënë është djegur kati i dyte konkretisht kuzhine me te gjitha orendit si banak kundrabanak divana frigorifer komplet kaldaje dy televizore etj. Gjithashtu nga zjarri i rënë është demtuar edhe pjesa tjetër e banesës nga tymi dhe bloza.

Në këtë zjarr ka marrë pjesë personeli i MZSH-së i stacionit të Shkodrës i turnit të 1(parë) me komandant turni Edison Suma me automjetin zjarrfikës Denise me targë AB575JB, automjeti Iveco 4 Tone dhe automjeti Iveco 8 Tone.

Nga ndërhyrja e jonë u bë e mundur mos perhapja e zjarrit në katin e trete te banesës dhe ne banesat përreth.

Stacioni i MZSH-së disponon dokumentacionin përkatës që vërteton rënien e këtij zjarri.

Ky vërtetim mbahet në tre kopje dhe përpilohet me kërkesën e të interesuarve për ta përdorur sipas nevojës.

**DREJTORI i MZSH-së**

(Komanduar)

Agim PONARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
DREJTORIA EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 23758 Prot

Shkodër, më 17.11.2025

URDHËR  
Nr. 1428, datë 17.11.2025

PËR  
NGRITJEN E GRUPIT TË KONSTATIMIT DHE VLERËSIMIT TË DËMEVE  
NË RASTE TË EMERGJENCAVE CIVILE

Në mbështetje të Ligjit 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8, pika 1 dhe 2, si dhe neni 64, pika a, i këtij ligji, dhe VKM. nr 329 datë 23.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerzore"

URDHËROJ:

- I. Ngritjen e grupit të konstatimit të dëmeve në raste fatkeqësish në lidhje me trajtimin e "Ndihmës financiare në rast djegie banese" për shtetasit : **Ndue Kolë Rrethaj**
- II. Grupi i konstatimit të përbëhet si më poshtë:
  1. Kol Ndrevashaj
  2. Besmir Lekaj
  3. Suad Mati
  4. Administratori Nj Adm Rrethina,
- III. Lëvizja e grupit të punës të koordinohet nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
- IV. Ky urdher hyn në fuqi menjëherë .

ME VENDIM DELEGIMI

Zv. KRYETAR

Alban PREKA



KRYETAR

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
DREJTORIA EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 3965 Prot

Shkodër, më 20 . 11 . 2025

URDHËR  
Nr. 451 , datë 20 . 11 . 2025

PËR  
NGRITJEN E GRUPIT TË KONSTATIMIT DHE VLERËSIMIT TË DËMEVE  
NË RASTE TË EMERGJENCAVE CIVILE

Në mbështetje të Ligjit 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8, pika 1 dhe 2, si dhe neni 64, pika a, i këtij ligji, dhe VKM. nr 329 datë 23.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerzore"

URDHËROJ:

- I. Ngritjen e grupit të konstatimit të dëmeve në raste fatkeqësish në lidhje me trajtimin e "Ndihmës financiare në rast djegie banese" për shtetasit : **Zamir Zyhdi Sylia, Mejreme Selim Samini, Lulzim Maliq Selja.**
- II. Grupi i konstatimit të përbëhet si më poshtë:
  1. Kol Ndrevasaj
  2. Besmir Lekaj
  3. Suad Mati
  4. Administratori Lagjia Nr.1, 4
- III. Lëvizja e grupit të punës të koordinohet nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
- IV. Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI**

**Zv. KRYETAR**

**Alban PREKA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA EMERGJECAVE CIVILE**

Shkodër, më 18.11.2025

**PROÇES VERBAL KONSTATIMI**

**Mbi gjendjen e banesës së djegur të Ndue Rrethaj në fshatin Grudë e Re ,NJ.Adm.Rrethina, Shkodër.**

I mbajtur sot, më datën 18.11.2025 në banesën e shtetasit Ndue Rrethaj në fshatin Grudë e Re ,NJ.Adm.Rrethina, Shkodër. mbi konstatimin e gjendjes së saj pas dëmeve të shkaktuara nga zjarri i rënë më dt. 06.11.2025 , sipas kërkesës së qytetarit me Nr. Praktike 8609 datë 07.11.2025, Mbështetur në VKM.nr. 329, datë 16.05.2012,”Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” dhe në zbatim të “Urdhërit të Brendshëm” të Kryetarit të Bashkisë Shkodër me Nr. 1429, datë 17.11.2025; nga verifikimi në vend i gjendjes së banesës ku banon familja e mësipërme në të cilën me datën 06.11.2025 ka rënë zjarr, u konstatua si më poshtë:

